



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KRYETARI

Nr. 452 Prot.

Tiranë, më 03.08.2026

U R D H Ë R

Nr. 211, datë 03.08.2026

**PËR
PEZULLIMIN E AFATEVE**

Në zbatim të nenit 12 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese,

U R D H Ë R O J:

1. Leja vjetore e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese do të bëhet nga data 3 gusht 2026 deri në datën 10 shtator 2026.
2. Periudha e lejes vjetore nuk llogaritet në afatet e parashikuara nga ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Një kopje e këtij urdhri të vendoset dhe të bëhet pjesë e dosjeve gjyqësore që ndodhen në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Njësia e Shërbimit Ligjor dhe Drejtoria Gjyqësore dhe Dokumentacionit për zbatimin e këtij urdhri.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e web-it të Gjykatës.

